



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:005315

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06511414

K.DH.SH.II.nr.836/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.SH “C” B.I., me NUI: 8164201111, me seli në Fshatin “...”, në Gjakovë, kundër debitorit “Condor” SH.P.K., me NUI: 8164395708, me seli në Fshatin Kramovik, në Rahovec, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1597/23 i datës 13.10.2023, me datën 26.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Condor” SH.P.K., me NUI: 8164395708, me seli në Fshatin Kramovik, në Rahovec, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1597/23 i datës 13.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1597/23 të datës 13.10.2023, e ka refuzuar prapësimin e debitorit “Condor” SH.P.K., dhe ka lënë në fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr.13/20 të datës 14.01.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të vërtetoj se debitori nuk ka asnjë obligim ndaj kreditorit

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T.SH "C" B.I., me seli në Fshatin "...", në Gjakovë, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit "Condor" SH.P.K, me seli në Fshatin Kramovik, në Rahovec, në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.164 të datës 31.05.2019, me të cilën ka kërkuar që debitori në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga fatura e lartcekur brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit shumën prej 1,400.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit, ashtuqë të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përmbarimit sipas llogarive bankare dhe bartjen e tyre në llogari të veçantë bankare të përmbaruesit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përmbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit..

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se nuk ka asnjë borxh ndaj kreditorit, dhe se ky fakt mund të vërtetohet nga barazimet të cilat janë pranuar dhe vërtetuar nga përfaqësuesit e të dy palëve ndërgjyqëse me anë të nënshkrimeve të tyre si dhe pagesat e ndryshme të realizuar të cilat e dëshmojnë se i tërë furnizimi me derivate nga kreditori është paguar me korrektësi sipas marrëveshjeve paraprake. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të miratohet në tërësi.

Kreditori në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se debitori ka paguar disa herë lidhur me shërbimet nga kreditori, por që fatura nr.164

e pranuar me datë 31.05.2020 nuk është paguar në tërësi. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit në mungesë të dëshmisë se është paguar fatura e lartcekur.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimi dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1597/23 të datës 13.10.2023, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e Përmbauesit Privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr.164 të datës 20.02.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Më tej gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret Fatura Nr. 164 e datës 22.02.2020, i plotëson edhe kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin nga ana e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të Përmbauesit Privat, me të cilin është caktuar përbarimi i propozuar nga kreditori. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të Faturës Nr.164 të datës 31.05.2019 e lëshuar nga kreditori e cila është në origjinal, e pranuar dhe e nënshkruar nga debitori. Kjo faturë e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përbarimit, sepse i përmban elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, sipas të cilit: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* si dhe është në pajtim me nenin 37 të LPP-së me të cilin parashihet se *“kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Prandaj, bazuar në këto arsye, kjo gjykatë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të

bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon si të rregullt dhe të bazuar në ligj.

Dhomat e Shkallës së Dytë i vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit se në rastin konkret i njejti ka paguar detyrimin sipas faturës lëndore, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa qëndrueshëm, për faktin se nga dëshmitë e pagesave të bashkangjitura në shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet fakti se debitori ka realizuar pagesa tek kreditori në raport me faturën Nr.164 të datës 31.05.2019 e cila i është bashkangjitur propozimit për përmbarim, kjo pasi që pagesa prej 6,0000 Euro dhe pagesa prej 863.00 Euro të cilat evidentohen në këto dëshmi pagese përshkruhen vetëm si “pagesë për derivate” pa u saktësuar fatura lëndore, prandaj edhe gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta marr si dëshmi për përmbushje të detyrimit nga ana e debitorit, përderisa nuk ekzistojnë prova konkrete që dëshmojnë se debitori ka përmbushur borxhin që rrjedh nga fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.836/24 me datë 26.11.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha